



REPUBLIKA E KOSOVËS
Komuna e Drenas /Glllogoc
Kuvendi i Komunës



Nr. 02-060/03-17557 dt. 13. 04. 2023

Në bazë të nenit 43 të Ligjit nr. 03/L-40 për vetëqeverisje Lokale, neni 36,41 dhe 42 pika 42.2 të Statutit të Komunës së Drenasit (Glllogocit), neni 3 pika 3.7 si dhe neni 12 pika 12.2 të Rregullores së punës të Kuvendit, Kryesuesi i Kuvendit të Komunës z. Milaim Hajdari, më datë: **20.04.2023**, (E Enjte) duke filluar në ora **10:00** në sallën e Kuvendit të Komunës.

THËRRET
MBLEDHJEN E RREGULLT TË KUVENDIT TË KOMUNËS

Mbledhja do të ketë këtë:

1. Procesverbali i mbledhjes së rregullt të Kuvendit Komunal të dt. 28.03.2023
2. Propozim vendim për transfer të mjeteve nga Projekti,
nr.10/611/850010/300/53732/0820, Kategoria e Shpenzimeve Kapitale në Projektin nr
10/611/850010/300/89114/0820 në buxhetin e drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport;
3. Propozim vendim për rritjen dhe bartjen e të hyrave vetanake .
4. Propozim vendim për miratimin e Planit Komunal për ri integrimin e qëndrueshëm të personave të riadhesuar dhe integritit të të huajve në Komunën e Drenasit/Glllogocit.
5. Të ndryshme.

Drenas, 13.04.2023



Kryesuesi i Kuvendit të Komunës

Milaim Hajdari



REPUBLIKA E KOSOVËS
Komuna e Drenas/Glllogoc
Zyra e Kuvendit



Rekomandimet e dhëna nga Komiteti për Politikë dhe Financa në mbledhjen e rregullt të mbajtur me datë 13. 04.2023, si vijon:

Pasi kryesuesi përshëndeti të pranishmit njoftoi anëtarët e K. P. F-ca, për rendin e ditës, pastaj i pyeti të pranishmit nëse ka dikush debat rreth pikave të rendit të ditës mundet me marr fjalën, diskutime nuk pati hedhi në votim rendin e ditës.

- Votuan 07 Për, Kundër: 00, dhe Abstenim: 00

1. Procesverbali i mbledhjes së Komitetit për Politikë dhe Financa i mbajtur më dt. 17.03.2023.

- Votuan 07 Për, Kundër: 00, dhe Abstenim: 00

2. Propozim vendim për transfer të mjeteve nga Projekti

nr.10/611/850010/300/53732/0820, Kategoria e Shpenzimeve Kapitale në

Projektin nr 10/611/850010/300/89114/0820 në buxhetin e drejtoratit për

Kulturë, Rini dhe Sport;

- Votuan 05 Për, Kundër: 00, dhe Abstenim: 02

3. Propozim vendim për rritjen dhe bartjen e të hyrave vetanake .

- Votuan 07 Për, Kundër: 00, dhe Abstenim: 00

4. Të ndryshme.

-Pati një kërkesë Florentina Elezi Velu rreth orarit të punës së barnatoreve për ditë vikendi dhe festave të bëhet një ndryshim se po bahen radhët e gjata në pritje për barna nga qytetarët. Dhe po ka barnatore që s'po e respekton orarin dhe s'po kanë ku i marrin shërbimet qytetarët.

-Kryetari Lladrovci u përgjigje se do të marrim parasysh kërkesën ta rregulloim nëse ka hapësirë sipas rregullores.

Pasi përfunduan diskutimet mbledhja përfundoi në ora 10: 50.



Kryesuesi i Kuvendit

Milaim Hajdari



Republika e Kosovës

Komuna e Drenasit

Kuvendi i Komunës



02 Nr.- 060/01-17558 dt. 13/04/2023

PROCESVERBALI

I mbledhjes se rregullt të Kuvendit Komunal të Drenasit të Mbajtur më datë: **28.03.2023**

Mbledhjen e kryesoi kryesuesi i Kuvendit Komunal-Milaim Hajdari

Kryesuesi deklaroi të hapura punimet e mbledhjes së rregullt të Kuvendit Komunal, ku të pranishëm ishin 31 anëtarë: Labinot Halilaj (PDK), Bekim Lestrani (PDK), Arigon Sinani (PDK), Zeqir Hasi (PDK), Laurita Muhadri Bujupi (PDK), Hamit Kastrati (PDK), Blerina Gashi (PDK), Gani Krasniqi (PDK), Fatmir Baliu (PDK), Qendrim Mulaj (PDK), Malsore Cakiqi (PDK), Agnesë Kastrati (PDK), Albulena Saliuku (PDK), Mirlinda Dvorani (PDK), Valentina Leku (PDK), Sali Dvorani (DD) Mergim Pirraku (DD), Mehedin Salihu (DD), Hamit Haxhiu (DD), Jahir Hajdari (DD), Azemine Bujupi-Gjoka (DD), Marigona Bazaj (DD), Florentina Elezi-Veliu (VV), Filloreta Bujupi (VV), Drin Halilaj (VV), Muhamet Kurtaj (VV), Egzona Terrdevci (VV), Arbër Halilaj (GREEN), Beqir Kiqina (AAK), Egzon Qorri (LDK).

Kuvendi filloi punimet më këtë : **Rend dite:**

1. Procesverbali i mbledhjes së rregullt i KK i mbajtur me dt. 23.02.2023.
2. Propozim vendim për formimin e komisionit për shqyrtimin e kërkesave dhe ankesave të palëve për emërtim të rrugëve, rrugicave dhe vendeve të tjera publike në Komunën e Drenasit.
3. Propozim vendim për caktimin e anëtareve të komisionit përzgjedhës për drejtor dhe zëvendës drejtor në Institucionet Publike Edukativo-Arsimore të Komunës së Drenasit.
4. Propozim vendim për këmbimin e pjesëve të njësive kadastrale në zonën kadastrale në Çikëtove të Vjetër dhe Glllogoc, për projektin e rregullimit të ngrohtores së qytetit të Drenasit.
5. Propozim vendim për lënie në shqyrtim publik të projekt dokumentit të Planit Rregullues të hollësishëm për qendrën e qytetit-Glllogoc, **në rishqyrtim.**
6. Propozim vendim për vënien në diskutim publik e rregullores për Bonuset e Zonimit, **në rishqyrtim.**
7. Propozim vendim për miratimin e Raportit përfundimtar të Komisionit Komunal për vlerësimin e Dëmeve nga fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë e tjera.
8. Raport i progresit për implementimin e rekomandimeve të ZKA-së.
9. Propozim Vendim për zëvendësimin me dy anëtar të rij të Komitetit për Komunitete dhe Kthim
10. Propozim Vendim për miratimin e Kërkesës Nr. 01-070/01-14724, dt. 27. 03.2023, për mjekim urgjent të sëmundjes -ana moli në zemër në shumën totale prej 3.000.00,euro.
11. Të ndryshme.

Të martën me dt. 28.03.2023 është mbajtur mbledhja e rregullt e Kuvendit të Komunës së Drenasit, ku për diskutim ishin 10 pika për rend dite.

Mbledhja është kryesuar nga kryesuesi i Kuvendit Komunal, Milaim Hajdari.

Në mbledhje morën pjesë, Kryetari i Komunës, Ramiz Lladrovci, nënkryetari Arben Shala, drejtor të drejtorive komunale, përfaqësues të KFOR-it, zyra e informimit.

Më poshtë ju elaborojmë pikat që janë diskutuar e miratuar me shumicë votash në mbledhjen e rregullt të Kuvendit të Komunës.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal, Milaim Hajdari- pasi përshëndeti të gjithë të pranishmit njoftoi me rendin e ditës anëtarët e Kuvendit Komunal.

Meqë nuk pati diskutime, vërejtje apo sugjerime tjera kryesuesi hodhi në votim rendin e ditës: prezent gjatë votimit ishin 30 anëtar, **(Për)** votuan 30 anëtar, kundër nuk pati, abstenim nuk pati, u miratua rendi i ditës.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal, Milaim Hajdari- hapi diskutimin për pikën e parë të rendit të ditës: **1. Procesverbali i mbledhjes së rregullt i Kuvendit Komunal Drenas të dt. 23.02.2023.**

Meqë nuk pati diskutime, vërejtje apo sugjerime tjera kryesuesi hodhi në votim këtë pikë të rendit të ditës: prezent gjatë votimit ishin 30 anëtar, **(Për)** votuan 30 anëtar, kundër nuk pati, abstenim nuk pati, u miratua kjo pikë e rendit të ditës.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal, Milaim Hajdari- hapi diskutimin për pikën e dytë të rendit të ditës: **2. Propozim vendim për formimin e komisionit për shqyrtimin e kërkesave dhe ankesave të palëve për emërtim të rrugëve, rrugicave dhe vendeve të tjera publike në Komunën e Drenasit.**

Kryesuesi i Kuvendit Komunal, Milaim Hajdari- kryesuesi njoftoj se komisioni duhet të formohet prej 5 anëtar nga Kuvendi Komunal.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal, Milaim Hajdari- propozoj për anëtar të komisionit Valentina Leku dhe Laurita Muhadri-Bujupi.

Azemine Gjoka, Nga grupi i asamblistëve i DD propozojmë për anëtar të komisionit Jahir Hajdarin.

Egzona Tërdevci, Nga grupi i asamblistëve i VV propozojmë për anëtar të komisionit Drin Halilaj.

Beqir Kiqina, Nga grupi i asamblistëve i AAK propozojmë për anëtar të komisionit Egzon Qorri.

Pas këtyre propozimeve të komisionit për shqyrtimin e kërkesave dhe ankesave të palëve për emërtim të rrugëve, rrugicave dhe vendeve të tjera publike në Komunën e Drenasit, kryesuesi hodhi në votim këtë pikë të rendit të ditës, prezent gjatë votimit ishin 30 anëtar, **(Për)** votuan 30 anëtar, kundër nuk pati, abstenim nuk pati, u miratua kjo pikë e rendit të ditës.

Komisioni për shqyrtimin e kërkesave dhe ankesave të palëve për emërtim të rrugëve, rrugicave dhe vendeve të tjera publike në Komunën e Drenasit u formua me këtë:

1. Valentina Leku
2. Jahir Hajdari
3. Drin Halilaj
4. Egzon Qorri
5. Laurita Muhadri Bujupi.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal, Milaim Hajdari- hapi diskutimin për pikën e tretë të rendit të ditës: **3. Propozim vendim për caktimin e anëtareve të komisionit përzgjedhës për drejtor dhe zëvendësdrejtor në Institucionet Publike Edukativo-Arsimore të Komunës së Drenasit.**

Muhamet Gjoka- Drejtori i Arsimit, ky propozim vendim vjen si obligim ligjor bazuar në udhëzimin administrativ 151/2020 dhe është obligim ligjor që të kalohet në kuvend, ku dy anëtar propozohen nga DKA-ja dhe përfaqësues i këshillit të prindërve në nivel komunal.

Egzona Tërdevci, anëtar i tretë i komisionit a emërohet prej MASHT-it apo si?

Muhamet Gjoka- Drejtori i Arsimit, në udhëzim e cek që anëtar i parë i komisionit është i punësuar në DKA, personi i tretë pasi të kalon në kuvend e njoftojmë ministrinë e arsimit dhe ministria na e dërgon përfaqësuesin e MASHT-it.

Meqë nuk pati diskutime, vërejtje apo sugjerime tjera kryesuesi hodhi në votim këtë pikë të rendit të ditës: prezent gjatë votimit ishin 30 anëtar, **(Për)** votuan 30 anëtar, kundër nuk pati, abstenim nuk pati, u miratua kjo pikë e rendit të ditës.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal, Milaim Hajdari- hapi diskutimin për pikën e katërt të rendit të ditës: **4. Propozim vendim për këmbimin e pjesëve të njësive kadastrale në zonën kadastrale në Çikëtove të Vjetër dhe Gillogoc, për projektin e rregullimit të ngrohtores së qytetit të Drenasit.**

Arbër Halilaj, në parim jam që të kaloj kjo sepse është projekt që po diskutohet që sa vite më përpara i kam dilemat e mija tek vlerësimi i vlerës së pronave që shkëmbehen ndërmjet komunës dhe feronikelit, nuk kemi ndonjë vlerësim të komisionit vlerësues prej ministrisë së financave dhe nuk kemi informata dhe çfarë prone po japim dhe çfarë po marrim vlerat e tyre, kështu që për vlerat e pronave unë abstenoj në votim, ndërsa si projekt jam për që të shtyhet përpara.

Egzona Tërdevci, vitin e kaluar i kemi ngrit disa shqetësime të banoreve të Çikatovës rreth një kontesti të pronave me feronikelin, nëse keni informacione kjo pronë e feronikelit që doni me këmbë me pronë komunale, a ka lidhje me ato prona?

Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci, vlerësimin e bën Ministria e Financave me komision të veçantë, nuk e bëjmë ne, asnjë pronë që është në emër të komunës nuk ka kontest me asnjë qytetar të komunës tonë, prona e feronikelit është tek "lagjja e feronikelit" ekipa e cila e ka bërë fizibilitetin në kuadër të qeverisë dhe në kuadër të Giz-it gjerman e kanë përcaktuar atë zonë sepse është pozita me e mirë gjeografike, strategjike për me vendos ngrohoren e qytetit dhe për ta bërë liqenin akumulues të ujit të ngrohtë, ajo do të jetë edhe një pjesë ku do të bëhet një lloj parki dhe shëtitore e qytetit tonë, nuk ka asnjë kontest me qytetaret.

Labinot Halilaj, nëse është kaq e domosdoshme u dashtë me qenë një arsyetim shumë më i fuqishëm se ky për me e votua këtë propozim vendim për ndryshim të kësaj parcele.

Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci, ne nuk e kemi bërë fizibilitetin e ka bërë nivelin qendror, niveli qendror e ka përcaktua atë zonë, dhe ne e kemi për obligim me e sjellë në kuvend me shpall interes të përgjithshëm dhe me këmbye me pronat tona, ne i kemi tri prona kufi me feronikeli dhe tri prona ia kemi ofruar në këmbim, vendos ministria për çmimin nuk kemi vendos ne.

Florentina Elezi-Veliu, kërkoj që meqë zyrtari ish prezent, kërkoj një sqarim nga ai për këtë propozim vendim.

Afrim Prokshi-zyrtar, që tri vite jemi në bashkëpunim me komisionin evropian, me Giz-in gjerman dhe Ministrinë e zhvillimit ekonomik, të gjitha komunat që janë të interesuara me aplikun, ne jemi ndër ato komuna që kemi aplikuar dhe fal dokumenteve dhe që i kemi plotësuar edhe kriteret ne e mesin e 38 komunave i kemi plotësuar kriteret. Kryetari i Komunës ka qenë i obliguar që ta formoj një komision që të ndihmoj rreth të dhënave të cilat kërkohen nga niveli qendror përkatësisht nga komisioni evropian në bashkëpunim me GIZ-in, dhe jemi në fund të fazës finale të hartimit të fizibilitetit dhe ka mbetur t'i caktohet vetëm lokacioni për vendosjen e paneleve solare, dmth është një risi që për herë të parë po formohet një ngrohje qendrore neper qytete, ku si burim i energjisë do të përdoret burimet e ripërtrishme të energjisë. Komisioni i caktuar nga GIZ dhe komisioni Evropian e ka caktuar vet zonën dhe e ka cek se kjo zonë është me e përshtatshme për vendosjen e paneleve dhe e kolektorëve solar pra është përcaktuar tek lagja e Feronikelit, fakti që është aty se kolektorët solar kanë me e ngroh ujin dhe gjithë energjia që përdoret për ngrohje qendrore është nga burimet e ripërtërihem dhe është shumë profitabil. Zona e cila përfshihet në ngrohje qendrore është zona e qytetit mirëpo në të ardhmen pritet që të jenë edhe një pjesë e Korretices së Ulet dhe Zabelit edhe një pjesë e Pokleut të Ri, është interes i përgjithshëm dhe është njëra ndër projektet më të mira të mundshme që mund t'ia sjellim komunës tonë.

Mehedin Salihu, është një sukses i padiskutueshëm, dhe do ta votojmë.

Meqë nuk pati diskutime tjera kryesuesi hodhi në votim këtë pikë të rendit të ditës: prezent gjatë votimit ishin 30 anëtar, (Për) votuan 29 anëtar, kundër nuk pati, 1 abstenim, u miratua kjo pikë e rendit të ditës.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal, Milaim Hajdari- hapi diskutimin për pikën e pestë të rendit të ditës: **5. Propozim vendim për lënie në shqyrtim publik të projekt dokumentit të Planit Rregullues të hollësishëm për qendrën e qytetit-Glllogoc, në rishqyrtim.**

Flutura Avdiu- Drejtoreshë e Drejtorisë për Planifikim Urban dhe Mbrojtje të Mjedisit, përshëndetje nga ministria e administrimit është kërkuar që projekt dokumenti për lënie në shqyrtim publik të projekt dokumentit të Planit Rregullues të hollësishëm për qendrën e qytetit-Glllogoc, **në rishqyrtim**, ministria ka konstatuar se duhet të shtohen disa nene, në hyrje të vendimit të shtohet neni 4 paragrafi 3, nenparagrafi 3.3 dhe të shtohet neni 8, 10, 12 nga UA nr 15/2014, në vend të nenit 2 të vendimit të konsultimeve publike sipas ligjit të planifikimit hapësinor i cili është pjesëmarrja dhe shqyrtimi publik, po ashtu të shtohen edhe nenet me nenin 8 njoftimi publik kohëzgjatja e shqyrtimeve publike, të shtohet paragrafi 1,2

nenparagrafi 2.1, 2.2, 2.3.4.5.6 kanë kërkuar nene shtesë që të vihen në preambule të vendimit.

Meqë nuk pati diskutime tjera kryesuesi hodhi në votim këtë pikë të rendit të ditës: prezent gjatë votimit ishin 30 anëtar, **(Për)** votuan 26 anëtar, 3 kundër, 1 abstenim, u miratua kjo pikë e rendit të ditës.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal, Milaim Hajdari- hapi diskutimin për pikën e gjashtë të rendit të ditës: **6. Propozim vendim për vënien në diskutim publik e rregullores për Bonuset e Zonimit, në rishqyrtim.**

Flutura Avdiu- Drejtoreshë e Drejtorisë për Planifikim Urban dhe Mbrojtje të Mjedisit, është kërkuar plotësim i nenit 39 i UA që të jetë në pajtim kjo projekt rregullore, edhe pse në aspekt procedural nuk i nënshtrohet vlerësimit të ligjshmërisë.

Meqë nuk pati diskutime, vërejtje apo sugjerime tjera kryesuesi hodhi në votim këtë pikë të rendit të ditës: prezent gjatë votimit ishin 30 anëtar, **(Për)** votuan 30 anëtar, kundër nuk pati, abstenim nuk pati, u miratua kjo pikë e rendit të ditës.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Milaim Hajdari- hapi diskutimin për pikën e shtatë të rendit të ditës: **7. Propozim vendim për miratimin e Raportit përfundimtar të Komisionit Komunal për vlerësimin e Dëmeve nga fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë e tjera.**

Meqë nuk pati diskutime, vërejtje apo sugjerime tjera kryesuesi hodhi në votim këtë pikë të rendit të ditës: prezent gjatë votimit ishin 30 anëtar, **(Për)** votuan 30 anëtar, kundër nuk pati, abstenim nuk pati, u miratua kjo pikë e rendit të ditës.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Milaim Hajdari- hapi diskutimin për pikën e tetë të rendit të ditës: **8. Raport i progresit për implementimin e rekomandimeve të ZKA-së.** Nuk pati diskutime.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Milaim Hajdari- hapi diskutimin për pikën e nëntë të rendit të ditës: **9. Propozim Vendim për zëvendësimin me dy anëtar të rij të Komitetit për Komunitete dhe Kthim.**

Kryesuesi sqaroi se janë te propozuar zëvendësimi i Agnesë Kastrati me Manushaqe Mulaku dhe nga anëtarët e bizneseve është zëvendësuar Sokol Gashani me Bedri Gllareva.

Meqë nuk pati diskutime, vërejtje apo sugjerime tjera kryesuesi hodhi në votim këtë pikë të rendit të ditës: prezent gjatë votimit ishin 31 anëtar, **(Për)** votuan 31 anëtar, kundër nuk pati, abstenim nuk pati, u miratua kjo pikë e rendit të ditës.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Milaim Hajdari- hapi diskutimin për pikën e dhjetë të rendit të ditës: **10. Propozim Vendim për miratimin e Kërkesës Nr. 01-070/01-14724, dt. 27. 03.2023, për mjekim urgjent të sëmundjes -ana moli në zemër në shumën totale prej 3.000.00,euro.** Meqë nuk pati diskutime, vërejtje apo sugjerime tjera kryesuesi hodhi në votim këtë pikë të rendit të ditës: prezent gjatë votimit ishin 31 anëtar, **(Për)** votuan 31 anëtar, kundër nuk pati, abstenim nuk pati, u miratua kjo pikë e rendit të ditës.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Milaim Hajdari- hapi diskutimin për pikën e njëmbëdhjetë të rendit të ditës: **11. Të ndryshme.**

Albulena Saliuku, pyeti Drejtorin e Arsimit në lidhje me rrethojën e SHFMU “Mehmet Gradica” në Gradicë.

I nderuar drejtor e vlerësoj punën dhe angazhimin tuaj si dhe investimi që është bërë brenda në shkollë, por sot dua të marrë një përgjigje nga ju se kur do të përfundojnë edhe rrethojat e shkollës e cila vetëm ka filluar dhe ka mbetur ashtu.

Nga kontaktet e vazhdueshme që kam me bashkëvendësit e mi ndjehen jashtëzakonisht të zhgënjyer se si vetëm shkolla e Gradicës është në këtë gjendje, fatkeqësisht gjendje aspak e mirë. Unë personalisht e kuptoj pozicionin tuaj por edhe e mendoj që punët duhet të merren me përgjegjësi të plotë sepse siç e dini nuk është hera e parë sot që iu drejtohem për të njëjtën kërkesë. Prandaj sot unë dhe gjithë bashkëvendësit e mi presim një përgjigje konkrete nga ju, se kur do të fillojë të punohet dhe të finalizohet kjo kërkesë.

Kur do të merr pamje të mirë shkolla që ka shërbyer edhe si spital ushtarak i UÇK-së, dhe po ashtu aty afër gjendet edhe qendra e mjekësisë familjare që e mban emrin e heroit Dr. Lec Gradica.

Pyetja e dyte ka të bëjë me ndriçimin e rrugëve në fshatin Gradicë, si projekt është përmendur që të përfundohet brenda vitit 2022 gjë e cila nuk ka ndodhur. A ka mundësi kushdo që mundet të më jep një përgjigje se kur të merren parasysh dhe me seriozitet kjo kërkesë pasi që edhe kjo është kërkesë e vazhdueshme nga bashkëvendësit e mi.

Muhamet Gjoka-Drejtori i Arsimit, sa i përket rrethojës së shkollës ju njoftoj se gjatë muajit prill do të përfundojë komplet, sa i përket investimeve me një numër jashtëzakonisht i vogël i nxënësve e kemi një investim të mirë dhe është një nder shkollat më të kompletuara.

Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci, sa i përket ndriçimit ka pas shqetësime të shumta të gjithë qytetareve, ASHP-ja nuk ka qenë funksionale afër dy vite, tani është lidhur kontrata me kompaninë dhe janë duke u zhvilluar punimet.

Egzona Tërdevci, është një shqetësim i përcjellë nga Shoqata e të Shurdhërve janë ankuar lidhur me subvencionimin që kanë marrë viteve të fundit sipas tyre nuk kanë marrë aq sa e meritojnë, ata na kanë treguar se janë të zot në disa aktivitete sportive mirëpo nuk po gjeje mbështetje dhe kanë paraqitur ankese rreth çështjes së objektit, deri në vitin 2016 kanë qenë në objekt në qendrën e re tregtare kurse nga viti 2016 ju është marrë edhe ajo mundësi, a mundeni me na tregu që ka me pas ndonjë objekt që mundet me ju dhënë në shfrytëzim atyre dhe si është çështja e subvencioneve për ata.

Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci, komisioni është ai i cili vendos kujt sa subvencionim më iu bërë, unë i kam shumë raportet e mira me shoqatën e të shurdhërve, ata i kanë objektet e veta në qendrën tregtare.

Hamit Haxhiu, e paraqiti një kërkesë nga stafi ndihmës teknik i dt. 03.03.2023 për një mbështetje financiare për punëtorët teknik tekniko-shërbyes të institucionet për Arsim dhe Aftësim profesional, kanë kërkuar të gjënë një marrëveshje që t’ju ndihmohet sa do pak punëtorëve teknik-shërbyes, dhe propozoi që të rishikoni se a kompensohen anëtarët e Komisionit Komunal të aksionarëve në Ndërmarrjen Publike Lokale Pastrimi.


Muhamet Gjoka-Drejtori i Arsimit, punëtorët teknik janë të kontraktuar me kontratë për kryerjen e shërbimeve.

Lumnije Krapi, drejtoreshë e shëndetësisë, aksionaret nuk paguhen prej komunës por por prej kompanisë të pastrimit, nuk ka të bëjë me bordin por me aksionaret.

Meqë nuk pati diskutime tjera kryesuesi e konsideroj të mbyllur seancën, seanca përfundoj rreth orës 11:30 min.

Me gjerësisht, mbledhjen e rregullt të Kuvendit të Komunës së Drenasit të datës 28.03.2023 mund të ndiqni në ueb faqen zyrtare të komunës, rrjetin social të Facebook-ut dhe në kanalin YouTube.

Procesmbajtëse:


Liridona Fejza-Ajazi



Kryesuesi i Kuvendit Komunal


Milaim Hajdari



REPUBLIKA E KOSOVES

KOMUNA E DRENASIT

Zyra e Kryetarit

Nr. 01-400/01-16822

Drenas, më 07.09.2023



Në vështrim të nenit 58 paragrafi 1, nën(h) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-040, Kryetari i Komunës së Drenasit propozon:

Në bazë të nenit 40, paragrafi 2. Pika (b) dhe (c) të Ligjit nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale dhe nenit 34 pika 34.6 nën (c) të Statutit të Komunës së Drenasit, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e vetë të mbajtur me datën _____ 2023 të miratoj këtë:

PROPOZIM – VENDIM

Për transfer të mjeteve nga Projekti nr 10/611/850010/300/53732/0820 Kategoria e Shpenzimeve Kapitale në Projektin nr 10/611/850010/300/89114/0820 në buxhetin e drejtoratit për Kulturë, Rini dhe Sport:

Neni 1

Me këtë Propozim –Vendim, miratohet transferi i mjeteve në kategorinë ekonomike Shpenzime Kapitale nga projekti nr 10/611/850010/300/53732/0820 ‘Ndërtimi i qendrave multifunksionale (Shtëpi e Kulturës: Muze, Arkiv, Bibliotekë,Teatër,Salla Filmi, Galeria e Arteve)Glllogoc, Tërstenik,Komaran” në Projektin nr 10/611/850010/300/89114/0820 Objekte Sportive Stadioni i Qytetit- Faza e dytë, në programin buxhetor të Drejtoratit për Kulturë,Rini dhe Sport.

Neni 2

Transferi i këtyre mjeteve bëhet nga kategoria ekonomike Shpenzime Kapitale i buxhetit të planifikuar i drejtorisë së Kulturës ,Rinisë dhe Sportit dhe miratuar nga Kuvendi i komunës, në kategorinë për Shpenzime Kapitale në projektet :

300,000.00 €

- Kodi i projektit : 10/611/850010/300/53732/0820 ‘Ndërtimi i qendrave multifunksionale (Shtëpi e Kulturës: Muze, Arkiv, Bibliotekë,Teatër,Salla Filmi, Galeria e Arteve)Glllogoc, Tërstenik,Komaran”.

.....

300,000.00 €

- Kodi i projektit : 10/611/850010/300/89114/0820 Objekte Sportive Stadioni i Qytetit- Faza e dytë

.....

Totali:

.....

300,000.00€

Shuma e mjeteve për transfer e përmendur në nenin 2 të këtij Propozim-Vendimi do të shpenzohen në kategorinë ekonomike Shpenzime Kapitale , konkretisht në projektet e lartshënuara.

Neni 3

Ky Vendim hyn në fuqi ditën e miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Drenasit, dhe për zbatimin e tij do të kujdeset: Kryetari i Komunës, Drejtorati për Kulturë, Rini dhe Sport.

 **KRYETARI I KOMUNËS**
Ramiz Lladrovci

Arsyetim

Në bazë të Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë nr. 03/L – 048 ,Komuna e Drenasit obligohet të miratoj Vendimin për transferin e mjeteve nga Projekti “Ndërtimi i qendrave multifunksionale (Shtëpi e Kulturës: Muze, Arkiv, Bibliotekë, Teatër, Salla Filmi, Galeria e Arteve)Gllgoc, Tërstenik, Komaran” tek Projekti Objekte Sportive Stadioni i Qytetit- Faza e dytë, të cilat mjete me herët kanë qenë të planifikuara dhe të miratuara nga Kuvendi i komunës së Drenasit, për këto dy projekte kapitale ku për Projektin Objekte Sportive Stadioni i Qytetit- Faza e dytë janë nënshkruar kontratat dhe memorandum bashkëpunimi me MRKS, niveli Qeveritar i ka destinuar si kategori shpenzime kapitale, shumë e kryer projektit në vlerën prej 300,000.00€, ku bartja është nevojë themelore nga dinamika e projekteve, mungesa e mjeteve financiare ,nevoja e domosdoshme dhe kërkesa nga Federata dhe Klubi Feronikeli për përmbylljen e fazës së dytë të këtij projekti andaj transferi i këtyre mjeteve është i domosdoshëm për realizimin e këtij projekti.



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Komuna e Drenasit
Zyra e Kryetarit



Nr

01-400/01-16908 dt. 02-04 2023

Në bazë të nenit 58, paragrafi 1 pika (h) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-040, nenit 72 të Statutit të Komunës së Drenasit, Kryetari i Komunës së Drenasit, propozon që në bazë të nenit 12 dhe 40 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës"), Kuvendi i Komunës së Drenasit në mbledhjen e mbajtur me datë _____ 2023, të aprovojë këtë:

PROPOZIM VENDIM
PËR RITJEN DHE BARTJËN E TË HYRAVE VETANAKE

Neni 1

Me këtë Propozim vendim, miratohet rritja dhe bartja e të hyrave vetanake nga viti 2022 në vitin 2023. Mjetet për rritje dhe bartje, janë të hyrat vetanake të pa shpenzuara gjatë vitit të kaluar dhe viteve tjera.

Neni 2

Të hyrat vetanake për rritje janë në shumë prej: **1,146,544.88 euro** dhe të hyrat e pa shpenzuara e që duhet të bartën nga fondi (21) janë në shumë prej: **270,627.97 euro** dhe nga fondi burimor (22) në shumë prej: **207,435.27 euro**.

Neni 3

Totali i mjeteve për rritje dhe bartje, në shumë prej: **1,624,608.12 euro** barten në këto kategori ekonomike:

Mallra dhe Shërbime	406,722.96 euro
Shpenzimet Komunale	24,000.00 euro
Subvencione dhe Transfere	29,853.81 euro
Shpenzime Kapitale	1,164,031.35 euro

Neni 4

Shuma e mjeteve për bartje nga rritja/tejkalmimi i realizimit të të hyrave kundrejt planfikimit dhe nga bilanci i pashpenzuar i fondit 21 nga viti paraprak, në nënprogramet dhe kategoritë e shpenzimeve si vijon:

Në kategorinë e shpenzimeve Mallra dhe Shërbime në nën programet si vijon:

Zyra e Kryetarit (16001) në vlerë prej:.....	54,391.47 €
Shërbimet e Shëndetësisë Primare (73100) në vlerë prej:	6,528.00 €
Planifikimi Urban dhe Inspeksioni (66310) në vlerë prej:.....	19,938.48 €

Infrastruktura Rrugore(18001) në vlerë prej:.....	12,361.49 €
Administrata (16301) në shumë prej:.....	30,000.00 €
Planifikimi i Zhvillimit Ekonomik (48001) në vlerë prej:.....	17,000.00 €
Infrastruktura Publike (18161) në vlerë prej:.....	20,000.00 €
Bujqësia (47001) në vlerë prej:.....	32,000.00 €
Arsimi Parashkollor (92210) në vlerë prej:.....	12,242.98 €
Administrat (92005) në vlerë prej:.....	108,642.60 €

Në kategorinë e Shpenzime Komunale në në programin:

Infrastruktura Rrugore (18001) në vlerë prej:.....	24,000.00 €
--	-------------

Në kategorinë e shpenzimeve Subvencione dhe Transfere në nën programet si vijon:

Infrastruktura Rrugore (18001) në vlerë prej:.....	10,485.04 €
Administrata (73010) në vlerë prej:.....	12,083.01 €
Zyra e Kryetarit (16001) në vlerë prej:	617.56 €
Administrata (92005) në vlerë prej:	1,150.10 €

Në kategorinë e shpenzimeve Kapitale në nën programet dhe projektet si vijon:

Infrastruktura Rrugore (18001) në projektin:

“Rregullimi dhe kultivimi i sipërfaqeve gjelbëruese,druj dekorativ ”, kodi (53313) në vlerë prej:.....	5,751.00 €
--	------------

Infrastruktura Publike (18161) në projektet:

“Zgjerimi dhe ndërtimi i Sheshit “Fehmi e Xhevë Lladrovci” Drenas,kodi (49297) në vlerë prej:....	900,000.00 €
“Rregullimi i shtratit të lumit Drenica – Verbica”,kodi(48254) në vlerë prej:.....	4,876.17 €
“Asfaltimi i rrugës në fshatin Arllat, Negroc, Gjergjicë si dhe Bytyq, kodi (48646) në vlerë prej:.....	65,752.50 €
“Asfaltimi i rrugës Zabel i Ulët e Epërme, Korroticë e Ulët dhe Epërme”,kodi (48658) në vlerë prej:.....	51,296.90 €
“Kanalizimi i ujërave të zeza Sankoc, Fushticë e Epërme dhe Ulët,kodi (48705) në vlerë prej:	5,109.00 €
“Kanalizimi i ujërave të zeza Gllanasellë dhe Godanc”,kodi (48710) në vlerë prej:.....	6,344.14 €
“Kanalizimi i ujërave të zeza Negroc, Kizhnarekë”,kodi (48713) në vlerë prej:	4,669.00 €
“Kanalizimi i ujërave të zeza Shtuticë, Verbovc dhe Polluzhë”,kodi (51323) në vlerë prej:.....	1,933.50 €

Arsim fillor,mesëm i ulët (93000) në projektin:

“Ndërtimi i fushave të jashtme sportive,rrethoja,Gelshani,Xh.Lladrovci dhe D.Drenices”,kodi(53691)....	10,000.00 €
--	-------------

Neni 5

Shuma e mjeteve për bartje nga bilanci i pashpenzuar i fondit 22 nga viti paraprak, në nënprogramet dhe kategoritë e shpenzimeve si vijon :

Në kategorinë e shpenzimeve Kapitale në nën programet dhe projektet si vijon:

Infrastruktura Publike (18161) në projektin:

“Zgjerimi dhe ndërtimi i sheshit “Fehmi e Xheva Lladrovci”,kodi (49297) në vlerë prej:.....108,299.14 €

Në kategorinë e shpenzimeve Mallra dhe Shërbime në nën programet si vijon:

Shërbimet Kadastrale (65005),në vlerë prej:.....	74,665.68 €
Administrata (16301),më vlerë prej:.....	2,806.42 €
Planifikim Urban dhe Inspeksioni (66310),në vlerë prej:.....	458.52 €
Shërbimet e Shëndetësisë Primare (73100), në vlerë prej:.....	108.00 €
Arsimi Parashkollor (92210),në vlerë prej:.....	15,579.32 €

Në kategorinë e shpenzimeve Subvencione dhe Transfere në nën programet si vijon:

Infrastruktura Rrugore (18001), në vlerë prej:.....	4,168.20 €
Administrata (92005), në vlerë prej:.....	1,349.90 €


Kryetari i Komunës
Ramiz Lladrovci



REPUBLIKA E KOSOVËS KOMUNA GLLOGOC GLLOGOC MUNICIPALITY			
PRANUAR		13/04/2023	
Nj. Org.	Numër	Shtojca	Vlera
21	830/01	17589	

Republika e Kosovës

Republika Kosova - Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

Komuna e Drenasit

Zyra Komunale për Kthim dhe Komunitete



Në vështrim të nenit 58, paragrafi 1, nënparagrafi h të Ligjit Vetëqeverisjes Lokale Nr.03/L-040, nenit 72 të Statutit të Komunës së Drenasit, Kryetari i Komunës së Drenasit, propozon: që në bazë të nenit 12 paragrafi 12.1, 12.2 pika d) dhe nenit 40 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 34.6 të Statutit të Komunës së Drenasit, Strategjinë për Migrim 2021 - 2025 të aprovuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës, Rregulloren (QRK) Nr.22/2020 Për Riintegrimin e personave të Riatdhesuar si dhe bazuar në Rregulloren për Integrimin e të Huajve (Rregullore (QRK) Nr. 09/2019 për integrimin e të huajve, Kuvendi i Komunës së Drenasit në mbledhjen e mbajtur me datë _____ 2023 të aprovoi këtë:

POPOZIM/VENDIM

**Për miratimin e Planit Komunal për Ri integrimin e Qëndrueshëm të personave të riatdhesuar dhe integritit të të huajve në Komunën e Drenasit
2023 - 2025**

Neni 1

Me këtë propozim Vendim Zyra Komunale për Kthim dhe Komunitete bazuar në Strategjinë për Migrim 2021 – 2025 të aprovuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës, Rregulloren (QRK) Nr.22/2020 Për Riintegrimin e personave të Riatdhesuar si dhe bazuar në Rregulloren për Integrimin e të Huajve (Rregullore (QRK) Nr. 09/2019 për integrimin e të huajve propozon që Kuvendi Komunal të aprovojë Planin Komunal për Ri integrimin e Qëndrueshëm të personave të riatdhesuar dhe integritit të të huajve në Komunën e Drenasit 2023 – 2025 .

Neni 2

Për zbatimin e këtij plani janë përgjegjëse Zyra Komunale për Kthim dhe Komunitete dhe Drejtoritë përkatëse Komunale .

Neni 3

Ky propozim vendim hyn në fuqi pas aprovimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Drenasit pas konfirmimit të ligjshmërisë nga ana e MAPL-së.



Kryetari i Komunës

Ramiz Lladrovci

ARSYETIM

Strategjia e Ri integritit ka për qëllim ri integrimin e qëndrueshëm socio-ekonomik të personave të riatdhesuar përmes avancimit dhe përmirësimit të vazhdueshëm të një sistemi efektiv e efikas të shërbimeve, të fokusuar në nevojat e të kthyerve.

Strategjia, si dokument qeveritar i politikave të ri integritit është obligative të zbatohet në tërë territorin e Republikës së Kosovës. Në kuadër të Planit të Veprimit të Strategjisë është paraparë edhe hartimi i Planeve Komunale për Ri integrim të qëndrueshëm. Me qëllim të zbatimit të koordinuar në praktikë të Strategjisë për Migrim 2022 - 2025, Zyra Komunale për Komunitete dhe Kthim (ZKKK) në bashkëpunim me Drejtoritë Komunale si dhe me përfaqësuesit e organizatave vendore e ndërkombëtare, si Grupi Punues, kanë hartuar Planin Komunal për ri – integrim të qëndrueshëm dhe Integrimin e të huajve për Komunën e Drenasit.

Plani i Veprimit përmban objektivat, aktivitetet konkrete dhe masat për arritjen e objektivave, përcakton institucionet përgjegjëse dhe mbështetëse për arritjen e secilit objektiv, saktëson kornizën kohore për realizimin e secilit aktivitet, koston e përafërt financiare për zhvillimin e aktiviteteve, indikatorët matës të objektivave dhe aktiviteteve dhe mjetet e verifikimit.

Plani është hartuar në bazë të Strategjisë për Migrim 2021 – 2025, Rregulloren (QRK) Nr.22/2020 Për Riintegrimin e personave të Riatdhesuar si dhe bazuar në Rregulloren për Integrimin e të Huajve (Rregullore (QRK) Nr. 09/2019 për integrimin e të huajve është miratuar në mbledhjen e 110 të Qeverisë së Kosovës, me vendimin nr. 01/110, datë 11.07.2019) dhe Planit të veprimit në nivel shtetëror, në bashkëpunim të ngushtë me MPB/DRPRIH si institucion përgjegjës për ri integrim në nivel nacional, dhe në vete ngërthen strukturën e saj, mirëpo duke pasur parasysh se ka të bëjë me nevojat e personave të riatdhesuar në Komunën e Drenasit përmban edhe aktivitetet specifike për vetë komunën dhe është e bazuar në të dhënat e siguruara nga Zyra Komunale për Komunitete dhe Kthim. Kështu, në këtë Plan është mundësuar integrimi maksimal i gjitha aktiviteteve për arritjen e ri integritit të qëndrueshëm të personave të riatdhesuar dhe integrimin e të huajve në Komunën e Drenasit.



Komuna Glogoc
Opština Glogovac

REPUBLIKA E KOSOVËS KOMUNA GLOGOC GLOGOC MUNICIPALITY			
PRANUAR	13	1041	2023
Nj. Org.	Numër	Shtojca	Vlera
01	0301014	17589	

PLANI KOMUNAL PËR RI INTEGRIMIN E QËNDRUESHËM TË PERSONAVE TË RIATDHESUAR DHE INTEGRIMIN E TË HUAJVE NË KOMUNËN E
GLOGOCIT
2023 - 2025

**Planin Komunal për Ri integrimin e Qëndrueshëm të personave të riadhesuar dhe integritit të të huajve në Komunën e Glllogocit
2023 - 2025**

Shkurtesat

ANP	Aeroporti Ndërkombëtar i Prishtinës
APRK	Ajensionit i Punësimit i Republikës së Kosovës
AZHBR	Ajencia për Zhvillim Bujqësor dhe Rural
BE	Bashkimi Evropian
DRPRIH	Departamenti për Ri integrim të Personave të Riatdhesuar dhe Integrimin e të Huajve
DKA	Drejtoria Komunale e Arsimit
EPPRM	Ekipi për Parandalim dhe Reagim për Mosbraktisje
KA	Komisioni për Ankesa
KASH	Korniza Afatmesme e Shpenzimeve
KKR	Komisioni Komunal për Ri integrim
MATP	Masat Aktive të Tregut të Punës
MAPL	Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
MASHTI	Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit
MBPZHR	Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural
MPJD	Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës
MFPT	Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve
MKK	Ministria për Komunitete dhe Kthim
MMPHI	Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
MPB	Ministria e Punëve të Brendshme
MSH	Ministria e Shëndetësisë
MSA	Marrëveshja e Stabilizim Asocimit
PR	Person i Riatdhesuar
PIR	Plani Individual i Ri integrimit
PII	Plani Individual i Integrimit
QAP	Qendrat e Aftësimit Profesional
QPS	Qendrat për Pune Sociale
SMR	Sistemi për Menaxhimin e Rasteve
ZKKK	Zyra Komunale për Komunitete dhe Kthim
ZP	Zyrat e Punësimit
ZGJC	Zyra e Gjendjes Civile

HYRJE

Qeveria e Republikës së Kosovës e ka aprovuar Strategjinë për Mingrim 2021 – 2025, Rregulloren (QRK) Nr.22/2020 Për Riintegrimin e personave të Riatdhesuar si dhe bazuar në Rregulloren për Integrimin e të Huajve (Rregullore (QRK) Nr. 09/2019 për integrimin e të huajve është miratuar në mbledhjen e 110 te Qeverise së Kosovës, me vendimin nr. 01/110, date 11.07.2019).

Në kuadër të Agjendës Evropiane të Kosovës, kriteret nga Udhërrëfyesi për Liberalizimin e Vizave të përcaktuara në Bllokun 0, Ri pranimi dhe Ri integrimi tashmë janë përmbyshur. Gjatë hartimit të Strategjisë për Ri integrim, janë adresuar të gjitha kërkesat që dalin nga Programi Kombëtar për Zbatimin e MSA-së.

Strategjia e Ri integrimit ka për qëllim ri integrimin e qëndrueshëm socio-ekonomik të personave të riatdhesuar përmes avancimit dhe përmirësimit të vazhdueshëm të një sistemi efektiv e efikas të shërbimeve, të fokusuar në nevojat e të kthyerve.

Strategjia, si dokument qeveritar i politikave të ri integrimit është obligative të zbatohet në tërë territorin e Republikës së Kosovës. Në kuadër të Planit të Veprimit të Strategjisë është paraparë edhe hartimi i Planeve Komunale për Ri integrim të qëndrueshëm. Me qëllim të zbatimit të koordinuar në praktikë të Strategjisë për Migrim 2022 - 2025, Zyra Komunale për Komunitete dhe Kthim (ZKKK) në bashkëpunim me Drejtorinë Komunale si dhe me përfaqësuesit e organizatave vendore e ndërkombëtare, si Grupi Punues, kanë hartuar Planin Komunal për ri – integrim të qëndrueshëm dhe Integrimin e të huajve për Komunën e Gillogocit.

Plani i Veprimit përmban objektivat, aktivitetet konkrete dhe masat për arritjen e objektivave, përcakton institucionet përgjegjëse dhe mbështetëse për arritjen e secilit objektiv, saktëson kornizën kohore për realizimin e secilit aktivitet, koston e përafërt financiare për zhvillimin e aktiviteve, indikatorët matës të objektivave dhe aktiviteve dhe mjetet e verifikimit.

Plani është hartuar në bazë të Strategjisë për Mingrim 2021 – 2025, Rregulloren (QRK) Nr.22/2020 Për Riintegrimin e personave të Riatdhesuar si dhe bazuar në Rregulloren për Integrimin e të Huajve (Rregullore (QRK) Nr. 09/2019 për integrimin e të huajve është miratuar në mbledhjen e 110 te Qeverise së Kosovës, me vendimin nr. 01/110, datë 11.07.2019) dhe Planit të veprimit në nivel shtetëror, në bashkëpunim të ngushtë me MPB/DRPRIH si institucion përgjegjës për ri integrim në nivel nacional, dhe në vete ngërthen strukturën e saj, mirëpo duke pasur parasysh se ka të bëjë me nevojat e personave të riatdhesuar në Komunën e Gillogocit përmban edhe aktivitetet specifike për vetë komunën dhe është e bazuar në të dhënat e siguruar nga Zyra Komunale për Komunitete dhe Kthim. Kështu, në këtë Plan është mundësuar integrimi maksimal i gjitha aktiviteve për arritjen e ri integrimit të qëndrueshëm të personave të riatdhesuar dhe integrimin e të huajve në komunën e Gillogocit.

Plani Komunal i Veprimit për riintegrimin dhe integrimin e qëndrueshëm të personave të riatdhesuar dhe të huaj 2023-2025									
Objekti 1:		Indikatorët për majen e arritjes së objektivit			Baza	Caku 2023	2025		
Avancimi i sistemit të ri integrimin për personat e riatdhesuar, duke aplikuar qasjen e orientuar në nevojat specifike për riintegrimin e personave të riatdhesuar dhe integrimin e të huajve		- Janë identifikuar nevojat e grupeve të cënueshme dhe shërbimet ofrohen bazuar në planin individual të riintegrimin dhe te integrimin; - Shërbimet e riintegrimin dhe integrimin monitorohen sistematikisht dhe ndërmerren masat e nevojshme përmirësuese; - Është arritur riintegrimi dhe i integrimin qëndrueshëm socio ekonomik i grupeve të cënueshme;			40%	60%	80%		
					50%	70%	80%		
					30%	50%	70%		
#	Masa	Veprimet	Indikatorët	Institucioni përgjegjës	Institucioni /partneri përkrahës	Kosto financiare	Afati kohor	Mjetet e verifikimit	
1.1	Identifikimi i nevojave të grupeve të cënueshme;	1. Realizimi i vizitave në familjet e kthyer, apo të posa ardhurve të huaj brenda 72 orëve pas kthimit, apo pas marrjes së statusit/leje qëndrimit në Kosovë, bashkërisht me përfaqësuesin e DRPRIH dhe QPS;	NR. i familjeve të cënueshme të kthyer, dhe të huaja në komunë Nr. vizitave të realizuara nga ekipi për VN Nr. i FVN të plotësuar Nr. i formularëve të vendosur në SMR	ZKKK DRPRIH/MPB	QPS DRPRIH/MPB Specialist shëndetësor Policia në komunitet - (Sipas nevojës) Organizatat vendore dhe ndërkombëtare me fokus riintegrimin dhe integrimin e të huajve në Kosovë	KA	Në vazhdimësi	Raportet nga tereni FVN i Plotësuar dhe nënshkruar nga palët SMR	
		2. Intervista familjen dhe plotëso formularin e Vlerësimit të Nevojave;							

1.2	Hartimi i planit individual të ri integritetit dhe integritetit, bazuar në pakot standarde të shërbimeve dhe nevojat e identifikuar në FVN;	3. Vendos FVN të skanuar në SMR	Nr. i Planeve Individuale të ri integritetit dhe integritetit, të hartuara;	ZKKK DRPRIH/MPB	QPS ZP Organizatave vendore dhe ndërkombëtare me fokus riintegrimin dhe integritetin e të huajve në Kosovë	KA	Në vazhdimësi	Planet Individuale të ri integritetit dhe integritetit në SMR
1.3	Zbatimi i planit individual të ri integritetit dhe integritetit përmes ofrimit i shërbimeve të ri integritetit të qëndrueshëm për grupet e ceneshme;	Këshillo personin e riatdhësuar dhe të huajin për parashtrim të kërkesave dhe informojë për afatet ligjore të parashtrimit të kërkesave; Ndihmo PR në plotësimin e kërkesave dhe dokumentacionit; Bashkëpunohet me drejtoritë përkatëse komunale për sigurimin e shërbimeve të nevojshme; Regjistron kërkesat dhe përfundimet në	Nr. i kërkesave të parashtruara, bazuar në PIR; Nr. dhe llojet e skemave të mbështetjes; Nr. i kërkesave dhe përfundimeve të regjistruara në SMR;	ZKKK DRPRIH/MPB	Drejtoritë komunale përkatëse DRPRIH/MPB ZP QAP Organizatave vendore dhe ndërkombëtare me fokus riintegrimin dhe integritetin e të huajve në Kosovë	BRK - Buxheti i ri integritetit dhe integritetit	Në vazhdimësi	Raportet e rregullta Kërkesat e parashtruara SMR

		SMR;			ZKKK DRPRIH/MPB	Drejtore të komunale përkatëse ZP Organizatat vendore dhe ndërkombëtare me fokus riintegrimin dhe integrimin e të huajve në Kosovë	KA	Në vazhdimësi	Raportet e tremujore të monitorimit dhe vlerësimit
